



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 18132 prot.

Vlorë, më 28.09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 5

DATE 28.08.2026 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2027 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.16533prot, datë 13.08.2026

Marrin pjesë:

Kryetare e Bashkisë Vlorë znj. Brunilda Mersini, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetari i Rajonit z.Hiqmet Gaçaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak – znj.Launela Dautaj, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxhaj, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 25 persona)

Takimin e hapi Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Përshëndetje dhe faleminderit që gjeni kohën dhe durimin për të qenë sot së bashku dhe për të ndarë idetë tona për zhvillimin e rajonit. Ne synojmë që secilit rajon t’i japim pjesën e buxhetit që i takon dhe ta orientojmë atë drejt nevojave dhe prioriteteve të komunitetit.

Në Rajonin 5, angazhimi i Bashkisë duhet të jetë edhe më i madh. Jemi përpjekur t’i japim një frymë të re kësaj zone, veçanërisht në drejtim të ndriçimit, infrastrukturës dhe përmirësimit të hapësirave publike. Sa i përket ujësjellës-kanalizimeve, dëshiroj t’ju informoj se administrimi i këtij shërbimi nuk varet nga Bashkia dhe, për rrjedhojë, Bashkia nuk ka vendimmarrje të drejtpërdrejtë në këtë fushë. Megjithatë, ka nisur një proces implementimi

për përmirësimin e furnizimit me ujë. Në lidhje me infrastrukturën rrugore, do të ndërhyhet në fundin e rrugës “Demokracia”, në rrugën pranë kopshtit “Sulo Didi”, si dhe në pjesë të tjera të rrugëve të Rajonit 5. Ka filluar gjithashtu rikonstruksioni i Kopshtit nr. 1, ndërsa në pjesën e rrugës së Transballkanikes është vendosur një semafor, me qëllim rritjen e sigurisë dhe përmirësimin e qarkullimit. Për tre rrugët e lagjes “Kushtrimi” ka filluar zbatimin e projektit për rehabilitimin e tyre. Ky proces përfshin edhe prishjen e disa banesave, të cilat janë në procedurë shpronësimi. Pas përfundimit të punimeve, zona do të ketë rrugë të rehabilituara dhe ndriçim të ri. Do të rindërtohen gjithashtu edhe muret e dëmtuara apo të prishura si pasojë e ndërhyrjeve. Në vitin 2027 do të nisë ndërtimi i godinës për emergjencat civile në këtë zonë, një investim i rëndësishëm për rritjen e sigurisë dhe kapaciteteve të reagimit në raste emergjencash.

Gjithashtu, për rrugën e KSHA-së dhe zonën e frigoriferit është hartuar një projekt për rehabilitimin dhe përmirësimin e përgjithshëm të kësaj zone. Dua të dëgjoj edhe ju për nevojat dhe prioritetet e zonës.



Banor: Kush do të ndërhyjë për zgjidhjen e problemit të ujësjellësit?

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Problematikat e ujësjellësit janë në kompetencë të shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve, e cila është përgjegjëse për administrimin dhe ndërhyrjet në këtë shërbim. Bashkia nuk ka kompetencë të drejtpërdrejtë vendimmarrëse mbi administrimin e ujësjellësit.

Banor: Kemi nevojë për rregullimin e rrugës pranë pallateve të vjetra.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Deri tani kemi ndërhyrë në 25 rrugë dhe puna do të vijojë edhe në zona të tjera. Do të fillojmë ndërhyrjet edhe në Bllokun e Orizit, ku parashikojmë rehabilitimin e rrugës, ndërtimin e trotuareve, krijimin e hapësirave të gjelbra dhe këndeve të lojërave, dhe heqjen e bolierëve.

me qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe të hapësirës publike për banorët.

Banor: Problem mbetet mungesa e gjelbërimit, rruga pranë shkollës “Rilindja” ka nevojë për rikonstruktion, si dhe për mbjelljen e pemëve dhe pastrimin e pusetave.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Në kuadër të punimeve për pastrimin e kanalit të ujërave të larta, u konstatua se mbi kanal ishin ndërtuar 7 banesa, për të cilat u krye procedura e shpronësimit. Sa i përket gjelbërimit, është menduar ndërhyrja në hapësirat që mund të shërbejnë për këtë qëllim. Për këto sipërfaqe do të verifikohet më parë gjendja juridike e pronës, për të përcaktuar nëse janë në pronësi private. Në rast se rezultojnë prona private, ndërhyrjet nuk mund të realizohen.

Banor: Falenderoi për punën e bërë për pastrimin e qytetit dhe kërkoi që kjo zonë të trajtohet me prioritet. Gjithashtu, kërkoi shtimin e numrit të koshave të mbeturinave, vendosjen e një sistemi vaditës, si dhe hapjen dhe pastrimin e pusetave. Gjithashtu, propozoi që hapësira pranë rrugës përballë Komisarariatit të përshtatet si lulishte.

Banor: Përgëzoi për punën e bërë në pastrimin e qytetit, duke theksuar se Vlora ka dalë në mejdan. Gjithashtu, kërkoi marrjen e masave për prishjen e garazheve.

Banor i lagjes “Kushtrim”, rruga “Sinam Ferati”: Ngre si problem përmbytjen e zonës nga ujërat e fabrikës së tullave dhe kërkoi që kjo zonë të përfshihet në planin rregullues. Gjithashtu, evidentoi nevojën për vendosjen e stolave dhe ndërtimin e banjove publike.

Banor: Falenderoi për punën e bërë, duke theksuar se rezultatet e saj janë të dukshme. Kërkoi që të ndërhyhet me prioritet në këtë rajon, veçanërisht në hyrje të qytetit. Gjithashtu, shpreh si problem mungesën e ujit të pijshëm.

Banor: Shpreh si problem ujërat e bardha dhe nevojën për rregullimin dhe pastrimin e pusetave. Gjithashtu, ngre shqetësimin për mungesën e ujit dhe kërkoi krijimin e një këndi lojërash për fëmijët.

Banor: Në zonën e pallateve të vjetra kërkohet heqja e bolierëve dhe pompave. Gjithashtu, problem shqetësues mbetet prania e qenve endacakë në rrugë. Në lagje nevojitet edhe vendosja e stolave për banorët.

Banor: Shprehim pakënaqësi lidhur me shërbimin e ujësjellësit. Gjithashtu, konstatohet shpërdorim i ujit pranë pompave. Lulishtja ka nevojë për vendosjen e stolave për banorët.

Banor: Rrethrotullimi në zonën e pusit të Mezinës bllokohet shpesh. Gjithashtu, ka servise që pengojnë qarkullimin e banorëve në lagjen “Kushtrim”

Banor: Nevojitet shtrimi i rreth 700 metrave rrugë përpara gjashtë pallateve të vjetra. Gjithashtu, problem mbetet shpërdorimi i ujit nga qytetarët, ndaj kërkohet ndërgjegjësim dhe marrja e masave për parandalimin e tij.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Do ta shqyrtojmë problematikën dhe më pas do të vlerësojmë mundësinë e ndërhyrjes.

Banor: Në zonën e Kastratit ndodhen dy subjekte që kanë ngushtuar rrugën. Kërkohet shqyrtimi i situatës dhe vlerësimi i mundësive për ndërhyrje. Gjithashtu, kërkohet rishikimi i tubacioneve kryesore të ujit.

Banor i lagjes “Kushtrim”: Kanalet kryesore janë të bllokuara dhe, në rast reshjesh, zona përmbytet. Problem shqetësues është edhe tymi i shkaktuar nga punimet. Gjithashtu vuan me mungesën e ujit.

Banor i lagjes “28 Nëntori”: Problem mbetet gjendja e rrugës, e cila ka nevojë për shtrim. Bëhet fjalë për rreth 200 metra rrugë.

Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini: Çdo ditë po vijojmë me asfaltimin e rrugëve.

Faleminderit!

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik
Aurora Kamberaj

